



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.101 dt.03.07.1998

**MBI SHQYRTIMIN E ANKESAVE PER DHENIE TE LEJEVE TE
NDERTIMIT NGA K.RR.T.**

Këshilli Bashkiak, në mbledhje e tij të dt.03.07.1998, pasi shqyrtoi ankesat e disa qytetarëve, disa prej të cilave të përcjella nga Prefektura e Tiranës, duke u mbështetur në ligjin Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, si dhe në ligjin Nr.8015, dt.19.10.1995 “Për disa ndryshime në ligjin Nr.7693, dt.26.04.1993 për urbanistikën, dhe pasi dëgjuan mendimin e Komisionit të Zhvillimit Urban dhe Ndërtimeve”

V E N D O S I

1. Kërkesa e Abdurrahim Keleshit për të marrë lejen e ndërtimit të banesës së tij të cilën nuk ia miraton K.RR.T.
Këshilli Bashkiak e gjen të drejtë refuzimin e K.RR.T., sepse banesa është ndërtuar pa leje.
2. Ankesa e familjes Celiku, njëra prej të cilave kundërshton lejen e sheshit të ndërtimit, ndërsa tjetra kërkon të sigurojë edhe lejen e ndërtimit për banesë 5 katëshe.
Këshilli Bashkiak, vendosi që të rregullohet problemi i pronësisë së një pjese të truallit pranë të cilës kërkohet të ngrihet ndërtesa 5 katëshe, dhe bashkëpronarët të merren vesh në dobi të një zgjidhjeje të pranueshme në përputhje me rregullat në fuqi.

3. Ankesa e ardhur nëpërmjet Prefekturës së Tiranës, sipas kundërshtimeve nga disa banore lidhur me lejen e ndërtimit për godinën e qytetarit K.Topalli.
Këshilli Bashkiak e gjen lejen të rregullt , sepse ndërtesat ekzistuese, megjithëse janë lartësuar pa leje ruajnë distancat nga ndërtimi që do të ngrihet, dhe leja e ndërtimit do të quhet e dhënë që prej momentit të prishjes së një ndërtimi pa leje.
4. Disa banorë të pallatit Nr.26, në rrugën “Vaso Pasha” kërkojnë të shtojnë në pjesën e prapme të këtij ndërtimi.
Këshilli bashkiak e gjen të drejtë vendimin e K.RR.T. për refuzimin sepse ndërtimi tashmë ka filluar.
5. Qytetari Rahman Gjordja kërkon një shtesë anësore në ndërtesën ku banon.
Këshilli Bashkiak vendosi që kërkesa e qytetarit Rahman Gjordjas të rishqyrtohet në K.RR.T.
6. Ankesa nga disa banorë të pallatit Nr.6 në rrugën “M.Gjollesha”, pranë kopshtit, se leja e ndërtimit e dhënë në sheshin pranë, dendëson masën e ndërtimeve.
Këshilli Bashkiak e gjen të drejtë lejen e K.RR.T. sepse distancat nga ndërtimi i lejuar dhe atyre ekzistuese respektohen.
7. Zbatimi i vendimit të bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Urbanistikës.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI